



DRITARJA PËR INVESTIME TË DIASPORËS HAP I RI PËR INVESTIME NË KOSOVË



DONATORËT



QEVERIA E
KOSOVËS



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIÇKOG NARODA

AGJENCIA AMERIKANE
PËR ZHVILLIM
NDËRKOMBËTAR (USAID)

KFW



BANKA GJERMANE
PËR ZHVILLIM (KfW)

BASHKËPUNËTORËT



AGJENCIA SUEDEZE PËR ZHVILLIM DHE
BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR (SIDA)



**MILLENNIUM
FOUNDATION
KOSOVO**



FONDACIONI KOSOVAR I MILENIUMIT (MFK)
dhe KOROPRATA E SFIDAVE TË MIJËVJEÇARIT



THE WORLD BANK
IBRD • IDA | WORLD BANK GROUP

BANKA BOTËRORE



Financimi përfiton nga mbështetja e Bashkimit Evropian në kuadër të Fondit për Garantimin e Kredive të krijuar sipas Rregullores (EU) Nr 1287/2013 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian për krijimin e Programit për Konkursueshmërinë e Ndërmarrjeve dhe Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (COSME) (2014-2020).



FONDI EVROPIAN I INVESTIMEVE (EIF)



BANKA EVROPIANE E
INVESTIMEVE (EIB)




U.S. International
Development
Finance Corporation

KORPORATA FINANCIARE E ZHVILLIMIT NDËRKOMBËTAR
TË SHITETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS (DFC)

INSTITUCIONET E REGJISTRUARA FINANCIARE





FONDI KOSOVAR PER GARANCI KREDITORE
KOSOVSKI FOND ZA KREDITNO JEMSTVO
KOSOVO CREDIT GUARANTEE FUND

Të nderuar lexues,

Kemi kënaqësinë që të prezantojmë edicionin e tetë të buletinit të Fondit Kosovar për Garanci Kreditore!

Buletini bart një mision të thjeshtë – të informojë publikun për punën, iniciativat dhe aktivitetet e institucionit tonë. Ky edicion i është dedikuar skemës më të re të FKGK-së të lansuar në korrik të këtij viti – Dritarja për Investime të Diasporës.

Gjatë 10 muajve të vitit 2024 FKGK inicoi shumë aktivitete, nga më të rëndësishmet vlen të veçohet Dritarja për Investime të Diasporës – një bashkëpunim midis FKGK, Ministrisë për Financa, Punë e Transfere dhe USAID, për të përmirësuar ambientin e të bërit biznes për diasporën kosovare. Prandaj këtë edicion të buletinit të FKGK-së ia kemi kushtuar Dritares për Investime të Diasporës me ç’rast ju sjellim artikuj nga akterët kyç në disenjimin dhe implementimin e kesaj iniciative. Sikur edhe në edicionet tjera, edhe në këtë edicion kemi përfshirë aktivitetet e shumta nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore gjatë periudhës Janar – Tetor 2024: trajnime, sesione orientuese, pjesëmarrje në forume, prezantim në panele të ndryshme, prezantime në institucione arsimore si dhe shumë aktivitete tjera.

Lexim të këndshëm!

PËRMBAJTJA

- 06 **OPINIONE**
BESNIK BERISHA - HAPJA E DRITARES PËR INVESTIME TË DIASPORËS – NJË DRITARE PËR RRRITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS
- 08 **OPINIONE**
HEKURAN MURATI - LANSIMI I DRITARES PËR INVESTIME TË DIASPORËS
- 10 **OPINIONE**
ARTAN SADIKU - ZHBLLOKIMI I POTENCIALIT TË INVESTIMEVE TË DIASPORËS NË KOSOVË
- 16 **NË PËRKUJTIM**
ALBAN KASTRATI
- 17 **DRITARJA PËR INVESTIME TË DIASPORËS**
- 19 **AKTIVITETET E FONDIT**
JANAR – TETOR 2024
- 27 **STORIE SUKSESI**
27 **NGA STARTUP – NË BINZES GLOBAL**
RRUGËTIMI I KOMPANISË TË PRODHIMEVE TË PLASTIKËS "SCAMPA"
- 28 **NJË SIMFONI E TË MËSUARIT BRENDA BOTËS MAGJEPSËSE TË QENDRËS LET NË PRISHTINË**
- 29 **"PEZULL" - NJË BIZNES ORIGJINAL**

Opinionet në këtë buletin nuk paraqesin politikën editoriale të FKGK-së

HAPJA E DRITARES PËR INVESTIME TË DIASPORËS NJË DRITARE PËR RRITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore si institucion i pavarur vazhdon të përmbushë misionin e tij kryesor, lehtësimin e qasjes në financa për NMVM-të. Në korrik të këtij viti, lansuam Dritaren për Investime të Diasporës, në një ngjarje ku ishin të pranishëm të gjithë aktorët kryesorë. Ngjarje kjo, jo vetëm që shënon një kapitull të rëndësishëm në rrugën e realizimit të misionit të institucionit tonë, por si asnjëherë më parë, kjo nismë, në mënyrë strukturore, mbështet investimet e sipërmarrjes private nga bashkatdhetarët tanë, që jetojnë dhe punojnë në vende të tjera, ndërkohë që vazhdojnë të ndiejnë përkatësinë dhe lidhjen me vendin tonë.

Ky është një nga kriteret kryesore që përcakton përshtatshmërinë e përfituesve për këtë skemë garantuese, e quajtur zyrtarisht me emrin DRITARJA PËR INVESTIME TË DIASPORËS.

Si edhe herave tjera në rastet e hapjes së dritareve garantuese në Fondin Kosovar për Garanci Kreditore, edhe Dritarja për Investime të Diasporës solli angazhimin e institucioneve vendore dhe atyre ndërkombëtare për të kontribuar në krijimin e një ambienti më të mirë të të bërit biznes në Kosovë.

Kur shkruajmë për Dritaren dedikuar diasporës, nuk mund të mos kujtojmë ndikimin që diaspora kosovare ka pasur në mbajtjen gjallë të idealit për shtetndërtim gjatë viteve të 90-ta, ndërsa pas lufte kontributin e tyre në rindërtimin dhe revitalizimin e vendit. Sukseset e diasporës kosovare në lëmi të ndryshme në vendet ku ata jetojnë, duke përfshirë edhe sukseset në biznes, nuk janë të rastësishme, por janë rezultat i punës së palodhshme, dëshirës për të prezentuar sa më mirë vendin e tyre pranë të tjerëve, e më së shumti mendësisë dhe gatishmërisë që kanë njerëzit tanë, për tu integruar dhe për të pranuar kulturat tjera. Prandaj, ofrimi i një programi mbështetës si ky i Dritares për Investimeve të Diasporës



BESNIK BERISHA
Drejtor Menaxhues - FK GK



Dritarja e Investimeve të Diasporës shërben si një urë lidhëse për ta bashkuar diasporën kosovare me mundësitë e biznesit në vendlindjen e tyre.

Këtë dritare kemi dashur ta dallojmë nga dritaret tjera dhe vlera e garancisë të rritet deri në 2.0 mil euro apo deri në 80% mbulueshmëri me garanci kreditore.

është gjëja më e vogël që ne mund ta bëjmë për të mundësuar një ambient sa më të favorshëm për këto investime. Është në interesin tonë pikë së pari, sepse është ekonomia e vendit tonë ajo që do të perfitojë më së shumti. Për këtë arsye, si asnjëherë më parë, këtë dritare kemi dashur ta dallojmë nga dritaret tjera dhe vlera e garancisë të rritet deri në 2.0 mil euro apo deri në 80% mbulueshmëri me garanci kreditore.

Kjo iniciativë, është kontribut i përbashkët i Qeverisë së Republikës së Kosovës, Fondit Kosovar për Garanci Kreditore dhe USAID-it për ta bërë realitet këtë ide, të nisur kohë më parë. Një sinergji mes tri palëve të përfshira thellësisht në proces – Qeverisë së Republikës së Kosovës, USAID-it dhe ne, bëri të mundur që të dalim me një instrument të ri dhe inovativ, duke i mundësuar diasporës që idetë e biznesit t'i bëjnë realitet në vendlindjen e tyre.

Në FKGGK, ne kemi qenë aktivisht të përfshirë në çdo fazë të realizimit të kësaj iniciative. Nga konceptualizimi deri te zbatimi, institucioni ynë ka marrë një rol udhëheqës për të siguruar që kjo skemë garancie të jetë e përshtatur për të përmbushur nevojat e investitorëve të diasporës, duke u ofruar atyre një mekanizëm të sigurt dhe të besueshëm për të kanalizuar burimet e tyre në investime produktive. Kjo nismë hap dyer të reja për kosovarët që jetojnë jashtë vendit për të kontribuar në zhvillimin ekonomik të Kosovës, krijimin e vendeve të punës, mbështetjen e ndërmarrësisë dhe forcimin e ekosistemit financiar të vendit.

Dritarja e Investimeve të Diasporës shërben si një urë lidhëse për ta bashkuar diasporën kosovare me mundësitë e biznesit në vendlindjen e tyre. Duke reduktuar rreziqet që lidhen me kreditimin për investitorët e diasporës, kjo skemë u mundëson institucioneve financiare vendase të ofrojnë financime më të qasshme, duke nxitur kështu ndërmarrësinë dhe investimet në vendlindje. Dritarja për Investime të Diasporës nuk është vetëm një instrument financiar – por është një mundësues i rritjes së qëndrueshme dhe një dëshmi për përkushtimin tonë kolektiv për ta ushqyer të ardhmen e Kosovës. Gjithashtu, ajo do të shërbejë si një instrument për të nxitur

institucionet financiare në Kosovë që për herë të parë të kreditojnë investitorë nga diaspora.

Edhe në këtë shkrim që i dedikohet dritares së diasporës, duam ta falënderojmë dhe çmujmë thellë kontributin e çmuar të kolegut tonë të ndjerë, Alban Kastrati, i cili ishte thellësisht i përfshirë në zhvillimin e kësaj nisme. Përkushtimi, vizioni dhe përpjekjet e palodhshme të Albanit luajtën një rol vendimtar në formësimin e Dritares për Investime të Diasporës në atë që është sot. Puna, përkushtimi dhe trashëgimia e tij do të mbeten në themelin e kësaj dritareje specifike dhe të institucionit tonë në përgjithësi, i cili synon të krijojë ndryshime pozitive të qëndrueshme për brezat që do të vijnë.

Ne besojmë se Dritarja për Investime të Diasporës do të shërbejë si një katalizator për transformimin ekonomik, duke tërhequr investime që do të ndihmojnë në ndërtimin e një Kosove të begatë dhe të lulëzuar. Ndërsa ecim përpara, ne mbetemi të përkushtuar për t'i mbështetur iniciativat inovative si kjo duke nxitur partneritetet me diasporën dhe duke krijuar një ekonomi më të fortë dhe më të qëndrueshme për të gjithë.

Derisa e shkruaj këtë artikull, tanimë kemi edhe rastin e parë të miratimit të kredisë së garantuar. Prandaj, jemi optimist dhe njëherit kureshtarë të shohim ndikimin e jashtëzakonshëm që do të ketë kjo dritare garancie për bizneset, për Kosovën dhe njerëzit e saj.



LANSIMI I DRITARES PËR INVESTIME TË DIASPORËS

Dritarja për Investime të Diasporës e lansuar në korrik të vitit 2024 ka për qëllim rritjen e investimeve të diasporës në Kosovë. Ndonëse, vullneti i diasporës për të investuar në Kosovë nuk ka munguar ndonjëherë, përmes Dritares për Investime të Diasporës, Qeveria në bashkëpunim me Fondin Kosovar për Garanci Kreditore dhe Qeverinë Amerikane ka synuar që rruga drejt këtyre investimeve të bëhet shumë më e lehtë.

Mërgata jonë që jeton në shtete të ndryshme të botës e cila ka krijuar historik kreditor në vendet ku ata jetojnë, zakonisht nuk e ka pasur të vështirë që të marrë kredi për të investuar në ato vende përkatëse. Megjithatë, për të investuar në Kosovë, mungesa e një historiku të tillë kreditor ka bërë shpesh që bizneset nga diaspora të trajtohen si start-ups. Kjo ka rezultuar në procedura burokratike të komplikuar dhe në nevojën për ofrimin e një kapitali të konsiderueshëm si hipotekë, për shkak se risku i vlerësuar nga ana e institucioneve financiare ka qenë shumë i lartë.

Dritarja për Investime të Diasporës do të krijojë një fond prej rreth 100 milionë eurosh për kreditimin e bizneseve nga diaspora, duke mundësuar aplikimin për kredi deri në vlerën 3 milionë euro. Ndërsa, garantimi për kreditë nga FKGK mund të jetë deri në vlerën 2 milionë euro. Të gjitha ndërmarrjet e reja apo ato ekzistuese të themeluara nga diaspora janë të ftuara të aplikojnë për kredi në bankat e Kosovës. Për më tepër, në bashkëpunim me USAID, disa biznese tashmë kanë mundësinë të aplikojnë edhe për grante që do t'i ndihmojnë në zgjerimin e mëtejshëm të biznesit.

Mbështetja për mërgatën dhe fuqizimi i mëtejshëm i rolit të saj ka qenë gjithmonë prioritet për Qeverinë. Kujtojmë se në



HEKURAN MURATI

Ministër i Financave, Punës dhe Transfereve



Dritarja për Investime të Diasporës do të krijojë një fond prej rreth 100 milionë eurosh për kreditimin e bizneseve nga diaspora, duke mundësuar aplikimin për kredi deri në vlerën 3 milionë euro. Ndërsa, garantimi për kreditë nga FKGK mund të jetë deri në vlerën 2 milionë euro.

korrik të vitit 2021, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve kishte lansuar programin "Bonot e Diasporës"

Ky program ishte një produkt financiar i garantuar nga shteti që paguante interes të liruar nga tatimi, me anë të të cilit i mundësohej mërgatës të investonte kursimet në njërën anë duke i kontribuar zhvillimit ekonomik të vendit në anën tjetër. Nga ky program u mbledhën rreth 10.43 milionë euro, të cilat më pas u orientuan drejt krijimit të vendeve të reja të punës përmes subvencionimit të kredive investuese për prodhuesit tanë.

Nga ky program, për një kohë shumë të shkurtër, u krijua një fond investimesh prej 100 milionë eurosh, investime këto që u përkthyen në më shumë vende pune e më shumë eksport.

Tutje, kësaj radhe, Dritarja për Investime të Diasporës e lehtëson financimin e projekteve duke i mundësuar mërgatës që përveç investimit në kapital e biznese, të sjellin pronën intelektuale; aftësitë, njohuritë dhe kulturën e punës nga vendet ku ata jetojnë. Pra, duke investuar kështu në një planifikim dhe administrim më të mirë të projekteve dhe ndërmarrjeve që zbatohen në Kosovë.

Këto janë vetëm disa nga përfitimet nga Dritarja për Investime të Diasporës, ku si qëllim fillestar është kthimi i diasporës për të investuar në vendin e tyre, por që sigurisht qëllimi afatgjatë dhe përfundimtar është kthimi i mërgatës sonë që të jetojnë në Kosovë.



ZHBLLOKIMI I POTENCIALIT TË INVESTIMEVE TË DIASPORËS NË KOSOVË

1. RACIONALIZIMI

Dritarja për Investime të Diasporës (DID), e lansuar më 16 korrik 2024 nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK), është programi më i ri inovativ i garantimit kreditor që synon të tërheqë investime nga diaspora kosovare.

Në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve (MFLT), dhe USAID-in, Aktiviteti për Promovimin e Investimeve dhe Qasjes në Financa e mbështeti edhe krijimin e Dritares për Investime të Diasporës, një skemë e garantimit kreditor për ndarjen e rrezikut e projektuar për të lehtësuar financimin për bizneset e diasporës.

Për të krijuar Dritaren për Investime të Diasporës, Qeveria e Kosovës, me saktësisht Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, zotoi një bazë kapitali prej 8 milionë eurosh. Përveç kësaj, Fondi Kosovar për Garanci Kreditore kontribuoi me 2 milionë euro kapital, duke rezultuar në një bazë të kombinuar të kapitalit prej 10 milionë eurosh për Dritaren për Investime të Diasporës.

Qasja në financa është thelbësore për të zhbllokuar potencialin e plotë të investimeve të diasporës. Megjithatë, investitorët nga diaspora shpesh përballen me pengesa në sigurimin e financimit për projektet në Kosovë. Këto pengesa mund të përfshijnë qasjen e kufizuar në shërbimet bankare tradicionale, mungesën e kolateralit ose historisë kreditore, si dhe mosnjohjen e peizazhit financiar lokal.

Komuniteti i diasporës kosovare përbën një burim të rëndësishëm të investimeve të mundshme dhe zhvillimit ekonomik për vendin. Me një popullsi në diasporë që vlerësohet mbi një milion individë që



ARTAN SADIKU

Udhëheqës i Promovimit të Investimeve, Aktiviteti i USAID-it për Promovim të Investimeve dhe Qasje në Financa



Komuniteti i diasporës kosovare përbën një burim të rëndësishëm të investimeve të mundshme dhe zhvillimit ekonomik për vendin. Fondi Kosovar për Garanci Kreditore kontribuoi me 2 milionë euro kapital, duke rezultuar në një bazë të kombinuar të kapitalit prej 10 milionë eurosh për Dritaren për Investime të Diasporës.

banojnë në vende të ndryshme të botës, shfrytëzimi i burimeve financiare dhe ekspertizës së investitorëve të diasporës është shumë i rëndësishëm për rritjen e qëndrueshme ekonomike të Kosovës. Dritarja për Investime të Diasporës nuk është thjesht vetëm edhe një produkt tjetër financiar; ajo është një instrument i përshtatur për t'u mundësuar investitorëve nga diaspora të fillojnë dhe të zgjerojnë projektet e investimeve në Kosovë, duke filluar nga start-up-et dhe bizneset e vogla e deri tek investimet më të mëdha infrastrukturore dhe prodhuese. Kjo është duke u realizuar për herë të parë në Kosovë.

Përfitimet nga zbatimi i Dritares për Investime të Diasporës janë shumë të rëndësishme. Ajo ofron qasje më të lehtë në financa për investitorët e diasporës, rrit vlerën e investimit dhe trason rrugën për rritje të qëndrueshme të biznesit. Me këtë zhvillim, Kosova mund të tërheqë investime të huaja dhe të ndër marrë projekte të rëndësishme zhvillimore.

2. POTENCIALI I INVESTITORËVE TË DIASPORËS PËR RITJE TË QËNDRUESHME EKONOMIKE

Ekzistojnë shumë tregues që demonstrojnë potencialin e diasporës kosovare për të përmirësuar mirëqenien ekonomike në Kosovë. Prurjet aktuale të remitencave përbëjnë 12% të Bruto Prodhimit Vendor (BPV) të Kosovës, duke përbërë kështu një burim jetik financiar për ekonominë vendore. Vendet gjermanofolëse, përkatësisht Gjermania, Zvicra dhe Austria, ku është kryesisht e përqendruar diaspora e Kosovës, janë burimi kryesor i Investimeve të Huaja Direkte (IHD). Megjithatë, ka shumë dëshmi që tregojnë se bizneset e diasporës janë duke bërë gjithnjë e më shumë investime në Kosovë, përfshirë edhe në sektorët e prodhimit dhe shërbimeve.

Për të thelluar rolin e diasporës kosovare në ekonominë e brendshme, qasja në financa është çështje kyçe. Aktualisht, financimi mbetet pengesa kryesore për investitorët e diasporës. Bankat komerciale janë konservatore në financimin e planeve

investuese nga investitorët e diasporës, pasi teknologjia e tyre e kreditimit bazohet në qarkullimin ekzistues të parasë së kompanive që kërkojnë financim kur e bëjnë vlerësimin e aftësisë kredituese të bizneseve aplikuese. Në një sondazh të bërë nga organizata joqeveritare vendore Germin, me pjesëmarrjen e 548 të anketuarve nga diaspora dhe 30 intervista me biznesmenë të diasporës, 24% e të anketuarve deklaruan se qasja në financa mund të ndihmojë në rritjen e gatishmërisë së tyre për të investuar në Kosovë. Bazuar në të njëjtin sondazh, bujqësia, ndërtimi, arsimiti, energjia, TI dhe turizmi janë sektorë tërheqës për investimet e diasporës.

Një sondazh tjetër nga Aktiviteti i USAID-it për Promovim të Investimeve dhe Qasje në Financa, i bërë në shkurt të vitit 2024, me pjesëmarrjen e 89 të anketuarve nga diaspora, zbuloi se përafërsisht 80% e tyre planifikonin të investonin në Kosovë. Rreth dy të tretat e të anketuarve deklaruan se do të investonin në Kosovë së bashku me një partner tjetër investues, dhe afro 40% deklaruan se do të investonin përmes një kredie bankare. Për më tepër, pavarësisht mostrës së kufizuar, të anketuarit nga diaspora deklaruan se do të investonin mesatarisht 1 milion euro në Kosovë. Gjashtëdhjetë për qind e të anketuarve deklaruan se qëllimi kryesor i investimit të tyre do të ishte eksporti i mallrave dhe shërbimeve. Një e treta e bizneseve të diasporës deklaruan se qasja në financa ishte sfida kryesore për investime në Kosovë.

Duke marrë parasysh konsideratat e paraqitura më lart, me Dritaren e sapo krijuar për Investime të Diasporës individët që punojnë dhe jetojnë jashtë vendit do të mund të aplikojnë për kredi deri në vlerën prej 3 milionë eurosh përmes bankave komerciale në Kosovë, dhe pjesëmarrja e tyre në kapital duhet të jetë të paktën 20% ose më shumë. Pas aplikimit, nëse investitori i plotëson të gjitha kriteret, Fondi Kosovar për Garanci Kreditore do të ofrojë garanci për kreditë e marra nga diaspora deri në vlerën prej 2 milionë eurosh. Përveç kësaj, Aktiviteti i USAID-it

për Promovim të Investimeve dhe Qasjes në Financë do të ofrojë mbështetje përmes një stimulimi në formë granti për një numër biznesesh, kreditë e të cilave janë garantuar nga FKGK përmes Dritares për Investime të Diasporës.

3. LANSIMI I FONDIT PËR RRRITJEN E BIZNESEVE TË DIASPORËS PËR MBËSHTETJE TË PROJEKTEVE TË REJA INVESTUESE NË KOSOVË

Për të mbështetur më tej bizneset e diasporës, Aktiviteti i USAID-it për Promovim të Investimeve dhe Qasjes në Financë e ka krijuar Fondin për Rritjen e Bizneseve të Diasporës, duke ofruar grante deri në 30,000 € (ose 33,000 USD) për kompanitë e kualifikuara të diasporës. Këto grante janë të destinuara për konsolidimin e biznesit, trajnimin e stafit, blerjen e pajisjeve, marketing dhe aktivitete të tjera kyçe që kontribuojnë në suksesin dhe rritjen e bizneseve të udhëhequra nga diaspora.

Aplikuesit nga diaspora duhet të sigurojnë një kredi bankare të garantuar nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore dhe duhet të paraqesin kontratën e kredisë bashkë me aplikimin për grant.

Fondi për Rritjen e Bizneseve të Diasporës synon të:

- Zgjerojë investimet direkte të diasporës në NVM dhe startup-e.
- Lehtësojë transferimin e njohurive dhe investimin e kapitalit nga diaspora në kompanitë vendore.
- Nxisë partneritete ndërmjet bizneseve të diasporës dhe ndërmarrjeve vendore.
- Aplikuesit e kualifikuar përfshijnë:
- Afaristë të diasporës të lindur në Kosovë që kanë jetuar jashtë vendit për më shumë se tri vite.
- Individë të diasporës së gjeneratës së dytë me lidhje familjare në Kosovë.
- Biznese që operojnë në Kosovë deri në 36 muaj.

Kjo nismë paraqet një mundësi unike për afaristët dhe investitorët e diasporës për të nxitur zhvillimin ekonomik të


qëndrueshëm në Kosovë, duke shfrytëzuar aftësitë, ekspertizën dhe kapitalin e tyre për të pasur ndikim afatgjatë.

Përveç mbështetjes me grante, Aktiviteti për Promovimin e Investimeve dhe Qasjes në Financa i USAID-it do të promovojë Dritaren për Investime të Diasporës në tregjet kryesore të diasporës, duke punuar ngushtë me MFLT dhe FKGK për të tërhequr investitorët e diasporës dhe për të rritur ndërgjegjësimin për këtë mundësi të re financiare. Kjo arritje e rëndësishme nuk do të ishte e mundur pa bashkëpunimin me Qeverinë e Kosovës, përkatësisht Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Fondin Kosovar për Garanci Kreditore. Ky partneritet nënvizon përkushtimin e përbashkët për të forcuar rrugën e Kosovës drejt prosperitetit ekonomik dhe për të rritur mundësitë për investime.

4. TRENDET E IHD-VE NË KOSOVË: SEKTORI I PASURIVE TË PALUAJTSHME DHE AKTIVITETET FINANCIARE PRIJNË NË INVESTIME GJATË 13 VITEVE TË FUNDIT

Dy sektorët kryesorë të Investimeve të Huaja Direkte (IHD) në Kosovë gjatë 13 viteve të fundit mbeten pasuritë e paluajtshme dhe aktivitetet financiare. Rreth 60% e prurjeve totale neto të IHD-ve kanë qenë të orientuara drejt pasurisë së paluajtshme, kryesisht blerja e pasurive të paluajtshme nga diaspora në Kosovë. Rreth 13% e prurjeve totale neto kanë qenë të orientuara në aktivitetet financiare dhe të sigurimeve, kryesisht të nxitura nga bankat e huaja komerciale dhe institucionet e tjera financiare. Rreth 7% kanë shkuar në ndërtim, 4% në prodhim dhe 4% të tjera në furnizim me energji elektrike, gaz dhe avull. Gjatë periudhës së vëzhguar, sektori me rëndësi strategjike i minierave ka pësuar një mungesë neto të investimeve.

Shpërndarja e IHD-ve të ardhura në Kosovë, ndonëse e fuqishme në sektorë të caktuar si pasuritë e paluajtshme dhe



Totali i investimeve të huaja sipas sektorëve 2010–2023, Burimi: Banka Qendrore e Kosovës.

shërbimet financiare, ngre shqetësime për cilësinë e investimeve sa i përket nxitjes së rritjes produktive dhe krijimit të vendeve të punës. Një pjesë e madhe e IHD-ve, veçanërisht ato 60% të orientuara drejt pasurive të paluajtshme, janë të nxitura nga konsumi dhe nuk kontribuojnë në zhvillimin ekonomik afatgjatë. Megjithatë investimet në pasuri të paluajtshme sigurojnë aktivitet ekonomik afatshkurtër, ato nuk krijojnë aq shumë vende pune ose nuk sjellin avancime teknologjike që mund të shtyjnë përpara ekonominë e Kosovës. Po ashtu, investimet e kufizuara në prodhimin industrial dhe sektorin e energjisë nënvizojnë sfidën e Kosovës për të tërhequr investime produktive që janë kyçe për rritjen e prodhimit industrial dhe për diversifikimin e ekonomisë.

Për të forcuar bazën ekonomike të Kosovës dhe për të ulur varësinë e saj nga sektorët joproduhues, është e domosdoshme që më shumë IHD dhe investime të brendshme të orientohen në fushat që mund të krijojnë vende pune, të nxisin inovacionin dhe të rrisin kapacitetin eksportues, veçanërisht në prodhim, teknologji, energji, infrastrukturë dhe shërbime me vlerë të lartë.

4.1 Pse Diaspora duhet të konsiderojë investimin në Kosovë: Përfitimet dhe mundësitë kryesore

Vendi ofron një nga regjimet tatimore më konkurruese në Evropë, me një normë të

tatimit mbi të ardhurat e korporatave prej vetëm 10% dhe pa tatim mbi dividendat, duke krijuar një ambient tërheqës për bizneset e diasporës që kërkojnë të kenë përfitim. Për më tepër, hapja e një biznesi është mjaft efiçente, me një proces regjistrimi që zgjat më pak se tri ditë. Kosova ka sektorë të konsoliduar të gatshëm për investime, duke përfshirë Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK), Prodhimin e Lehtë dhe Energjinë dhe Resurset Natyrore. Këto industri kanë një histori të dëshmuar dhe paraqesin mundësi të shumta për rritje, duke e bërë vendin një destinacion tërheqës për investitorët që duan të hyjnë në tregje të pjekura. Vendi ofron qasje të lehtë në tregjet kryesore, përfshirë Bashkimin Evropian (BE) me mbi 500 milionë konsumatorë dhe vendet e CEFTA-s me 21 milionë të tjerë. Pozita strategjike e Kosovës ofron një rrugë të favorshme për tregti ndërmjet Evropës dhe Azisë, duke e bërë Kosovën qendër për kompanitë e diasporës që synojnë zgjerimin ndërkombëtar. Kosova po ashtu krenohet me popullsinë më të re në Evropë, me mbi 70% të popullsisë nën moshën 35 vjeç. Kjo fuqi punëtore e re dhe e talentuar është shumë e aftë, veçanërisht në sektorin e teknologjisë së informacionit dhe sektorët e tjerë inovativë. Një pjesë e madhe e popullsisë flet disa gjuhë, përfshirë anglisht dhe gjermanisht, çka e bën më të lehtë për bizneset ndërkombëtare të lulëzojnë. Me

koston më të ulët të fuqisë punëtore në Evropë, mesatarisht 521 euro në muaj, vendi ofron një mjedis me kosto shumë efektive për veprimtari të biznesit. Kjo strukturë me kosto të ulët, e kombinuar me kthimet e larta të mundshme, e bën Kosovën një vend fitimprurës për investitorët e diasporës. Vendi po ashtu ka një regjim tregtar liberal që mundëson ulje ose heqje të plotë të tarifave për eksportet në BE, Mbretërinë e Bashkuar dhe vendet e CEFTA-s. Këto marrëveshje tregtare mundësojnë hyrjen e lehtë në tregje për bizneset, duke ofruar qasje në destinacionet kryesore të eksportit. Kosova ka qenë e suksesshme në tërheqjen e investimeve të huaja direkte (IHD), me 2.6 miliardë euro të investuara në pesë vitet e fundit dhe me pothuajse 200 biznese në pronësi të huaj të krijuara vetëm vitin e kaluar. Eksportet drejt Evropës dhe SHBA-së kanë arritur në 3 miliardë euro, duke demonstruar se ka një kërkesë të madhe për produktet dhe shërbimet e ofruara në Kosovë. Për investitorët e diasporës që duan të kenë ndikim kuptimplotë derisa përfitojnë nga kthimet e konsiderueshme ekonomike, Kosova ofron një mundësi strategjike me kosto të ulët dhe rritje të lartë në zemër të Evropës.

5. KONKLUZIONE

Diaspora kosovare paraqet potencial të madh të pashfrytëzuar për të kontribuar në rritjen e qëndrueshme ekonomike të vendit. Me mbi një milion kosovarë që jetojnë jashtë vendit dhe me remitencë që kontribuojnë me 12% të BPV-së së Kosovës, investitorët e diasporës përfaqësojnë burimin kryesor të IHD-ve në sektorë të rëndësishëm si bujqësia, TI, energjia, prodhimi, arsimit dhe turizmi. Krijimi i Dritares për Investime të Diasporës ofron një mekanizëm jetik për investitorët e diasporës që të kenë qasje në kredi dhe garanci, me mbështetje nga FKGK. Kjo skemë e garantimit kreditor për ndarjen e rrezikut, e mbështetur edhe nga MFLT dhe Aktiviteti i USAID-it për Promovimin e Investimeve dhe Qasjen në Financa, është e para e këtij lloji në Kosovë dhe do të sigurojë garanci për kreditë deri në 2 milionë euro.



Një sondazh nga Aktiviteti i USAID-it për Promovim të Investimeve dhe Qasje në Financa, i bërë në shkurt të vitit 2024, me pjesëmarrjen e 89 të anketuarve nga diaspora, zbuloi se përafërsisht 80% e tyre planifikonin të investonin në Kosovë. Prurjet aktuale të remitencave përbëjnë 12% të Bruto Prodhimit Vendor (BPV) të Kosovës, duke përbërë kështu një burim jetik financiar për ekonominë vendore.

Në lidhje me Dritaren për Investime të Diasporës, Fondi për Rritjen e Bizneseve të Diasporës ofron grante deri në 30,000 € për bizneset e kualifikuara të diasporës. Kjo mbështetje financiare shtesë synon të lehtësojë kostot operative dhe të nxisë rritjen e bizneseve të udhëhequra nga diaspora, duke kontribuar më tej në zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Pjesëmarrja e palëve të ndryshme, përfshirë MFLT, FKGK, Aktivitetin e USAID-it për Promovimin e Investimeve dhe Qasjen në Financa dhe institucionet financiare vendore në promovimin dhe lehtësimin e investimeve të diasporës pasqyron një qasje gjithëpërfshirëse dhe bashkëpunuese për zhblokimin e potencialit ekonomik të Kosovës përmes angazhimit të diasporës.

TË ARRITURAT E FKGGK-së

DERI MË 31 TETOR 2024



16,578

NUMRI I KREDIVE



14%
GRA

PRONARE/
BASHKËPRONARE



394
MILIONË EURO

GARANCIONE
TË APROVUARA



758
MILIONË EURO

KREDI TË
APROVUARA



10,623

NDËRMARRJE MIKRO,
TË VOGLA DHE TË MESME
BIZNESE TË GARANTUARA



27,983

VENDE TË
REJA PUNE

NË PËRKUJTIM!

Me 8 korrik të këtij viti, me dhimbje të thellë morrëm lajmin për humbjen e kolegut tonë të dashur, Alban Kastrati.

Albani ishte pjesë e Fondit Kosovar të Garancisë Kreditore që nga fillet e para të themelimit të institucionit të FKGK-së.

Përkushtimi i tij për zhvillimin e politikave dhe procedurave për menaxhimin e rrezikut ka qenë një vlerë e lartë përgjatë nëntë viteve të punës në FKGK.



ALBAN KASTRATI

1976 - 2024

Në rolin e tij në fond, Albani ishte përgjegjës për menaxhimin e rrezikut kreditor dhe atë operacional, duke demonstruar vazhdimisht njohjen e tij të thellë në këtë fushë. Ishte një bankier i arrirë me diplomë në Banka dhe Financa nga Fakulteti i Ekonomisë në Prishtinë dhe kishte përfunduar studimet master për Administrim Biznesi në Universitetin e Lubjanës në Slloveni.

Me më shumë se 11 vjet përvojë në sektorin bankar ai ka shërbyer në pozita të ndryshme menaxheriale si Menaxher i Alokimit të Kredive Biznesore, Zëvendës Drejtor i Departamentit Komercial dhe Korporatave dhe Koordinator i Kredive.

Përkushtimi i palëkundur, përsosmëria profesionale dhe prania e ngrohtë e Albanit do t'u mungojë thellësisht të gjithë atyre që patën privilegjin të punojnë me të. Trashëgimia e tij e disiplinës dhe përkushtimit ndaj punës, do të vazhdojë të na frymëzojë gjithmonë.

U prefsh në paqe Alban!

Përjetësisht në zemrat tona.





Dritarja për Investime të Diasporës

Dritarja për investime të diasporës ka për qëllim që të mbështes investimet në ndërmarrësi private të themeluara nga bashkatdhetarët tanë që jetojnë dhe punojnë në vende të tjera. Iniciativa e Dritarës së Diasporës synon të ofrojë një qasje gjithëpërfshirëse për të lehtësuar investimet nga diaspora kosovare - individët që punojnë dhe jetojnë jashtë vendit. Objektivi kryesor i kësaj dritareje është të mbështesë investimet e reja nga diaspora dhe t'i drejtojë këto fonde drejt krijimit të sipërmarrjeve të reja ose forcimit të atyre që sapo janë krijuar për të synuar arritjen e objektivave kyçe të zhvillimit ekonomik.

Ka shumë tregues që dëshmojnë potencialin e diasporës kosovare për të përmirësuar mirëqenien ekonomike në Kosovë. Aktualisht remitencat përbëjnë 12% të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) të Kosovës, duke qenë një burim financiar jetësor për ekonominë vendore. Kjo dritare është krijuar në bashkëpunim me Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe me donatorët si USAID.

Si pjesë e Dritares së Investimeve të Diasporës, Aktiviteti i USAID përkrahë këtë iniciativë duke krijuar një Fond për Rritjen e Bizneseve të Diasporës për të mbështetur investitorët të cilët kualifikohen sipas kriterëve përkatëse. Kapitali total për këtë dritare është 10 milionë euro, ku tetë milionë euro kontribuon Qeveria e Kosovës dhe 2 milionë Fondi Kosovar për Garanci Kreditorë.

ÇKA KONSIDEROJMË INVESTIM NGA DIASPORA DHE CILAT JANË KËRKESAT LIGJORE?

Bashkatdhetarët mund të shprehin qëllim të qartë për të investuar në Kosovë duke:

- Inicuar themelimin e një biznesi të ri, ose
- Investuar në një biznesin egzistues në Kosovë ku janë pronarë ose bashkëpronarë.

Bizneset që janë në pronësi/bashkëpronësi të një investitori nga diaspora e që kanë përvojë më të gjatë se 36 muaj nuk kualifikohen për këtë dritare.

Struktura e pronësisë së bizneseve të sapo krijuara nga investitorët e diasporës, duhet të jetë në:

1. Pronësi të plotë të investitorit të diasporës.
2. Partneritet me banorë të Kosovës (shembull: partnerë biznesi, të afërmit e familjes, miqtë që jetojnë dhe punojnë në Kosovë) ose
3. Nëse investitori nga diaspora themelon një biznes me një bashkëinvestitor të huaj (jorezident të Kosovës).

Në të tri rastet e lartëpërmendura, investitori nga diaspora duhet të zotërojë së paku 30% të pronësisë së ndërmarrjes. Investitori duhet ta mbështesë idenë e themelimit të biznesit/ndërmarrjes së re me një plan biznesi.

Pajtueshmëria me kërkesat dhe rregullativën ligjore:

Aplikuesit duhet t'i respektojnë të gjitha ligjet, rregulloret dhe udhëzimet përkatëse që rregullojnë investimet dhe aktivitetet e biznesit në Kosovë. Për më tepër, aplikuesi do t'i nënshtrohet një procesi të vlerësimit të kujdesit të duhur kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit nga ana e institucionit të regjistruar financiar, dhe nuk duhet të jetë subjekt i ndonjë procesi gjyqësor ose pjesë e ndonjë liste të sanksioneve ndërkombëtare.

CILAT BIZNESE KUALIFIKOHEN?

Ndërmarrja mikro e vogël dhe e mesme (NMVM) kërkohet të jetë:

- Në pronësi private të themeluar nga investitori që gëzon statusin e investitorit nga diaspora.
- E regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK).
- Ndërmarrje e themeluar nga diaspora që kanë përvojë pune jo më të gjatë se 36 muaj.
- Gjithëpërfshirëse për sektorë të ndryshëm përveç atyre të ndaluara sipas politikës së menaxhimit mjedisor e social të FKGK-së.
- Investitor me histori të mirë kreditorë nga vendi përkatës ku jeton e vepron apo edhe në Kosovë.
- Biznes me më pak se 250 punonjës.

Info shtesë lidhur me origjinën Kosovare të pronarit të biznesit:

- Të gjithë ata që fillimisht kanë lindur dhe jetuar në Kosovë, por kanë emigruar dhe kanë jetuar për më shumë se tre vjet jashtë vendit.
- Pasardhësit (gjeneratat e reja) të prindërve kosovarë, duke u shtrirë në gjeneratën e dytë, me origjinë nga Kosova.

CILAT KREDI MUND TË PËRFITTOJNË NGA DRITARJA PËR INVESTIME TË DIASPORËS? Kreditë e Kualifikuara që plotësojnë kriteret e mëposhtme do të jenë të pranueshme për përfitime nga Dritarja për Investime të Diasporës:

- Shuma minimale e kredisë është 3,000 euro.
- Shuma maksimale e kredisë është 3,000,000 euro.
- Shuma minimale e garancisë është 1,500 euro.
- Shuma maksimale e garancisë është 2,000,000 euro.
- Afati minimal i kthimit të kredisë së garantuar do të jetë 3 muaj.
- Afati maksimal i kthimit të kredisë së garantuar do të jetë 84 muaj.
- Qëllimi i kredisë mund të jetë për investime të ndryshme afariste (asete fikse, pajisje, kapital qarkullues).

LLOJI I KREDISË

Kredi; Linjë kreditore; Mbitërheqje.

CILAT JANË KARAKTERISTIKAT E GARANCISË?

- Mbulueshmëri me garanci kreditore deri në 80% të kryegjësë së kredisë por jo më shumë se 2,000,000 euro. Përqindja e mbulueshmërisë me garanci kreditore varet nga vlera e investimit fillestar, e cila është e obligueshme të jetë në vlerë prej së paku 20%. *

***Përqindja e mbulueshmërisë me garanci sipas pjesëmarrjes në investim fillestar/ kredi bankare**

Mbulueshmëria garancisë (%)	Pjesëmarrja në investim fillestar/ kredia bankare (%)
60	20/80
70	25/75
80	30/70

CILI ËSHTË PROCESI I APLIKIMIT DHE VENDIMARRJES?

- Huamarrësi potencial (NMVM) nuk aplikon për garanci por aplikon për kredi në njërin nga Institucionet e Regjistruara Financiare të FKGK-së.
- Institucioni i Regjistruar Financiar (IRF) pasi që të kryen analizat e zakonshme të kredisë duke zbatuar standardet e vlerësimit të riskut dhe nëse kompania i plotëson kriteret e FKGK-së atëherë IRF përkatëse e vendosë kredinë nën garancinë kreditore të FKGK-së .
- Pas vendosjes së kredisë përkatëse nga ana e IRF-së përkatëse në Sistemin për Menaxhimin e Informatave të FKGK-së, FKGK e pranon kredinë nën garancinë kreditore.

Ndërmarrja mikro, e vogël, apo e mesme që garantohet në Dritaren për Investime të Diasporës do të ketë mundësinë që të përfitojë edhe një grant në vlerën 5,000 deri në 30,000 euro. Ky grant ipet nga Aktiviteti i USAID-it për Promovim të Investimeve dhe Qasje në Financa.”

Aktiviteti i USAID-it në Kosovë për Promovimin e Investimeve dhe Qasje në Financa është projekt pesëvjeçar që ka filluar në mars 2023.



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE

Fondi për Rritjen e Bizneseve të Diasporës

Aktiviteti i USAID-it për Promovim të Investimeve dhe Qasje në Financa fton bizneset e diasporës dhe investitorët e diasporës që kanë marrë kredi përmes **Dritares për Investime të Diasporës** të dorëzojnë aplikimet e tyre për **financim të granteve për të tërhequr mundësi investimi** në Kosovë.

Njo'tim për Mundësi të Financimit

Kush mund të aplikojë?
Kjo mundësi për grante është në dispozicion **vetëm për:**

- ✓ Aplikantët të cilët tashmë kanë marrë kredi nga një bankë e Kosovës dhe
- ✓ Kredia është garantuar nga **Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK)**.

Financimi i granteve është në dispozicion për fushat e mëposhtme:

- Planifikim afarist dhe financiar
- Konsolidim i biznesit
- Shërbime të marketingut
- Menaxhim organizativ
- Blere të makinerive
- Shërbime këshilluese relevante
- Trajnim të stafit

Shumat e granteve do të variojnë nga:

5,000€ deri në:
30,000€

Aplikimet janë të hapura nga:
9 gusht 2024 deri më 31 korrik 2025.

Për informacione shtesë dhe paketen e aplikimit:



SCANIMI QR-KODIT

Aktiviteti i USAID-it për Promovim të Investimeve dhe Qasje në Financa
është i USAID-it për Promovim të Investimeve dhe Qasje në Financa, financuar nga Agjencia e Shtetit e Bashkuarë për Tregti dhe Investime të Jashtme dhe i USAID-it, i cili është një DT Global e bashkëpunimit, që bashkëpunon me Sektorin e Tregtisë dhe Investimeve të Jashtme të Kosovës.

AKTIVITETET E FONDIT

JANAR - TETOR 2024

Shkurt 2024 – FKGK u prezantua në sesionin trajnues operacional organizuar nga Shoqata e Institucioneve Garantuese të Europës (AECM) në Bruksel, me temën “Produktet financiare për një Europë të qëndrueshme: dixhitalizimi, tranzicioni në teknologji dhe energji”. Dy përfaqësuese të FKGK-së, Nora Arifii - Menaxhere e Lartë e Portofolit dhe Anita Toçi – Specialiste për Komunikim, mbajtën prezantimin e titulluar “Rruga drejt qëndrueshmërisë dhe dixhitalizimit”.



Mars 2024 – FKGK mbajti ligjeratë në RIT ku u prezantua për rëndësinë dhe rolin e skemave garantuese në zhvillimin ekonomik. Gjatë kësaj ligjerate, përmes shpjegimeve dhe shembujve, studentët kishin mundësi të mësojnë se si funksionojnë skemat garantuese dhe çka ofrojnë për NMVM-të; Për ndërlidhjen që këto skema garantuese kanë me zhvillimin ekonomik. Ligjeratën e mbajtën z. Besnik Berisha dhe z. Kastriot Këpuska në klasën e Prof. Fadil Sahiti.



Mars 2024 – FKGK ishte pjesë e konferencës “Qasja në Financa për Gratë Ndërmarrëse”, e organizuar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës dhe AMIK. Znj. Nora Arifi – Menaxhere e lartë e portofolit, prezantoi mundësinë që ofron dritarja “Gratë në biznes” nga FKGK për gratë ndërmarrëse, e që ka për qëllim lehtësimin e qasjes në financa si dhe avancimin e njohurive financiare. Përmes dritares “Gratë në biznes” të FKGK-së përveç lehtësimit në qasje në financa, kjo dritare përmbanë edhe komponentin jofinanciar që përfshinë zgjerimin e njohurive lidhur me financa për këtë kategori. Pra, gratë ndërmarrëse mbështeten edhe në aspektin e ngritjes së kapaciteteve që përfshijnë: edukimin financiar, formalizimin, rrjetëzimin dhe mentorimin.



Mars 2024 – FKGK mbajti një ligjeratë në Universitetin e Mitrovicës "Isa Boletini" me ç'rast prezantoi rëndësinë dhe rolin e skemave garantuese në zhvillimin ekonomik. Gjatë kësaj ligjerate, përmes shpjegimeve dhe shembujve, studentët kishin mundësi të mësojnë se si funksionojnë skemat garantuese dhe çka ofrojnë për NMVM-të; Për ndërlidhjen që këto skema garantuese kanë me zhvillimin ekonomik. Ligjeratën e mbajtën z. Alban Kastrati dhe znj. Anita Toçi për studentët e vitit të dytë dhe të tretë të Fakultetit Ekonomik.



Prill 2024 – FKGK u paraqit në konferencën hibride të organizuar nga Finance in Motion dhe përkrahur nga EFSE dhe Komisioni Evropian. Znj. Nora Arifi, Menaxhere e lartë e portofolit në FKGK, me këtë rast, e ka ndarë përvojën tonë si institucion lidhur me komponentën jofinanciare të dritares për gratë në biznes, trajnimin e organizuar dhe realizuar për avancimin e njohurive financiare të grave ndërmarrëse.



Prill 2024 – FKGK mbajti një ligjeratë në Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren për studentët e Fakultetit Ekonomik, me ç'rast prezantoi rëndësinë dhe rolin e skemave garantuese në zhvillimin ekonomik. Gjatë kësaj ligjerate, përmes shpjegimeve dhe shembujve, studentët kishin mundësi të mësojnë se si funksionojnë skemat garantuese dhe çka ofrojnë për NMVM-të; Për ndërlidhjen që këto skema garantuese kanë me zhvillimin ekonomik. Ligjeratën e mbajtën z. Besnik Berisha – Drejtor menaxhues në FKGK dhe znj. Anita Toçi - Specialiste për komunikim, për studentët e Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Prizrenit.



Prill 2024 – Katër anëtarë të personelit të FKGK-së certifikohen me titullin- Ekspert i certifikuar për Menaxhim të Riskut në shkollën e Frankfurtit për Financa dhe Menaxhim, në trajnimin CERM.

Maj 2024 – FKGK shënoi përvjetorin e tetë të themelimit, duke organizuar një tryezë diskutimi “ Zbutja e hendekut financiar – Roli i FKGK-së në lehtësimin e qasjes në financa”. Në këtë tryezë u zhvillua bisedë konstruktive, ku të gjithë pjesëmarrësit kishin rastin për të reflektuar, diskutuar dhe elaboruar për impaktin që shërbimet tona kanë në ekonominë e vendit. FKGK prezantoi të arriturat, sfidat përgjatë këtyre tetë viteve, si dhe u shpalos rezultati i hulumtimi të fundit që FKGK ka zhvilluar e që ndërlidhet me mundësitë e lehtësimit të qasjes në financim dhe impaktin tonë në këtë drejtim. Të pranishëm ishin institucionet financiare partnere, donatorë, si dhe bashkëpunëtorët kyç të FKGK-së, të cilët i falenderojmë për pjesëmarrje dhe kontributin e tyre në këtë tryezë diskutimi.



Maj 2024 – Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë, bashkë me Fondin Kosovar për Garanci Kreditore, u përkujdesën për largimin e mbeturinave në një pjesë përreth liqenit të Badovcit. Përkushtimi ynë që të mbrojmë ambientin dhe të ndikojmë në mirëqenien e qytetarëve është misioni i vazhdueshëm.



Qershor 2024 – FKGK dhe Community Development Fund - CDF nënshkruan marrëveshje partneriteti me qëllim të organizimit të trajnimeve për gratë ndërmarrëse. Si pjesë e komponentës jofinanciare këto trajnime organizohen me qëllim të zgjerimit dhe zhvillimit të njohurive që kanë të bëjnë me edukimin financiar për gratë në biznes. Marrëveshjen e nënshkruan znj. Nermin Mahmuti – drejtoreshë ekzekutive në CDF dhe z. Besnik Berisha – drejtor menaxhues në FKGK.



Qershor 2024 –FKGK vazhdoi ciklin e trajnimeve për dritaren GROW, kësaj radhe i organizuar për biznese. Dritarja GROW u dedikohet bizneseve që investojnë në energji të ripërtërishme (ER) dhe eficiencë të energjisë (EE), për t’ju lehtësuar qasjen në financa. Qëllimi kryesor i FKGK-së për organizimin e këtyre trajnimeve është eksplorimi i mundësive të reja për bizneset e sektorit të gastronomisë si: Njohja me teknologjitë në energji eficiente dhe energji të ripërtërishme; veçoritë e dritares GROW; Informimi më i zgjeruar për rëndësinë e FKGK-së në lehtësimin e qasjes në financa për investimet e ardhshme në EE/RE të rëndësishme për zhvillimin dhe stabilitetin e bizneseve të këtij sektori; Zgjerimi i njohurive për të gjitha skemat garantuuese (dritaret) e FKGK-së në përgjithësi. Në këtë seancë ishin të pranishëm përfaqësues të tetë bizneseve të sektorit të gastronomisë.



Qershor 2024 – Asociacioni Evropian i Institucioneve Garantuese (AECM) është duke mbajtur ngjarjen vjetore me temë “Tranzicioni Binjak: Drejt një Ekonomie të Gjelbër dhe Digjitale”. Ngjarje zhvillohet në Varshavë të Polonisë. FKGK përfaqësohet nga z. Agan Azemi - Kryesues i Bordit të FKGK-së dhe z. Vilson Ukaj – Specialist i Lartë Ligjor në FKGK. Gjithashtu, z. Vilson Ukaj ka kontribuar në panelin diskutues me temën “Sistemet e brendshme të kontrollit të skemave garantuese”.



Qershor 2024 – FKGK pjesë e Konferencës: Roli i ESG si udhërrëfyes i sektorit privat që u mbajt për Ditën Botërore të Konsulentit Për ta shenuar ditën e konsulencës, Këshilli i Konsulentëve të Biznesit (BCC), në bashkëpunim me USAID Kosova Compete Activity organizuan tryezën e rrumbullakët me temën “Roli i ESG si udhërrëfyes i sektorit privat”. Fondi Kosovar për Garanci Kreditorë përfaqësuar nga znj. Nora Arifi ishte pjesë e panelit të diskutimit me ç’rast ndau me audiencën rëndësinë e implementimit të parimeve të ESG-së, si dhe iniciativat që FKGK ka ndërmarrë për zbatimin e këtyre parimeve.



Korrik 2024 – FKGK ka vazhduar ciklin e trajnimeve për dritaren GROW, përmes konsulencës nga MACS, që kësaj rradhe ishin dy seanca, njëra për biznese të sektorit të ndërtimitarisë dhe seanca tjetër për biznese nga sektori i tekstilit. Dritarja GROW u dedikohet bizneseve që investojnë në energji të ripërtërishme (ER) dhe efikasitet të energjisë (EE), për t’ju lehtësuar qasjen në financa.



Korrik 2024 – Qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe Fondi Kosovar për Garanci Kreditorë, në bashkëpunim me USAID-in kanë nënshkruar sot marrëveshjen trepalëshe për lansimin e skemës së re garantuese, “Dritarja për Investime të Diasporës”. Kjo iniciativë synon tërheqjen e investimeve nga diaspora dhe lehtësimin e qasjes në financa për bizneset e diasporës që janë të gatshme të investojnë në Kosovë. Në këtë ngjarje ishin të pranishëm Kryeministri i Republikës së Kosovës z. Albin Kurti, Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Z. Hekuran Murati, Ambasadori i Shteteve të Bashkuara në Amerikë, Z. Jeffrey Hovenier, zyrtarë të lartë qeveritarë, përfaqësues të lartë të Bankës Qendrore të Kosovës, partnerëve dhe donatorëve të FKGK-së.



Gusht 2024 – FK GK nënshkruan marrëveshje me të gjitha IRF-të për DRITAREN E DIASPORES



Gusht 2024 – FK GK nënshkruan marrëveshjen e garancisë me PriBank. Kjo ngjarje shënon zgjerimin e marrëveshjeve që FK GK realizon me Institucionet Financiare. Gjithashtu, me anë të kësaj marrëveshjeje, FK GK do të mbulojë deri në 50% të rrezikut të kredive për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, gjë që do ti mundësojë PriBank të zgjerojë kredidhënien për bizneset kosovare.



Shtator 2024 – Përfaqësues të FK GK-së mbajtën dy seanca trajnimi për stafin e PriBank e cila në muajin gusht ju bashkua FK GK-së. Fokus i këtyre seancave trajnuese ishin temat në vijim: Informata të përgjithshme për FK GK-në; Skemat garantuese - kuptimi dhe definicioni i tyre; Veçoritë e dritareve të FK GK-së; Dritarja Standarde; Sistemin e menaxhimit mjedisor dhe social.



Shtator 2024 – FK GK ishte pjesë e emisionit Startup në RTV21, për të diskutuar për Dritaren për Investime të Diasporës. Në këtë emision mysafir ishte përfaqësuesi i FK GK-së z. Kastriot Këpuska i cili shpalosi informata të gjera lidhur me Dritaren për Investime të Diasporës.



Shtator 2024 – FK GK pjesë e ngjarjes " Lansimi i Iniciativës së Gjelbër" të organizuar nga BpB. Në ngjarjen e organizuar nga Banka për Biznes e cila shënon nisjen zyrtare të Iniciativës së Gjelbër, Fondi Kosovar për Garanci Kreditore ishte pjesë e panelit me temën "Rëndësia e Ekonomisë së Gjelbër për Biznese dhe Individë" që u përfaqësua nga z. Besnik Berisha Drejtor Menaxhues i FK GK-së.



Tetor 2024 – Në kuadër të promovimit të Dritares për Investime të Diasporës, në Berlin të Gjermanisë, në Global Albanian Gastronomy Festival është vendosur shtandi me përfaqësues nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore dhe USAID Investment Promotion and Access to Finance Activity.



Tetor 2024 – FKGK pjesë e Forumit të 2-të Ekonomik Gjermano – Kosovar, organizuar nga Shoqata Gjermano-Kosovare e Biznesit. Në ditën e parë të këtij Forumi, u mbajt paneli diskutues me fokus në qasjen në financa. Në këtë panel FKGK përfaqësuar nga drejtori menaxhues z. Besnik Berisha, theksoi rolin dhe rëndësinë e skemave garantuese në lehtësimin e qasjes në financa për NMVM-të.



Tetor 2024 – Gjatë kësaj jave Fondi Kosovar për Garanci Kreditore ishte pjesë e konferencës për Turizëm të Qendrueshëm, organizuar nga PPSE Program Swisscontact. Znj. Nora Arifi - Menaxhere e Lartë e Portofolit- ishte pjesë në panel diskutimi "Rruga e Kosovës drejt Turizmit të Qendrueshëm".



Tetor 2024 – APROVOHET KREDIA E PARË E GARANTUAR NGA FKGK PERMES DRITARES SE DIASPORES



Tetor 2024 – FK GK dhe Banka Zhvillimore KfW sot nënshkruan marrëveshjen për të vazhduar forcimin e bashkëpunimit financiar që synon mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NMVM) në Kosovë.

Kosova përfituesja më e madhe në regjion nga projekti EU-KfW Garanci për Ballkanin perëndimor – Përkrahja e ndërmarrësve dhe NMVM-ve përmes marrëveshjes "Garancia për Ballkanin Perëndimor BE-KfW – Mbështetja e qëndrueshmërisë së ndërmarrësve dhe MSME-ve", është pjesë integrale e përpjekjeve të vazhdueshme për të përkrahë rritjen dhe zhvillimin ekonomik, për të zgjeruar qasjen në financa dhe për të nxitur rritjen e qëndrueshme në të gjithë rajonin.

Kjo nismë e financuar nga Bashkimi Evropian dhe implementuar përmes Bankës për Zhvillim KfW në një shumë totale prej 22,133,5 euro, që përbën pjesën më të madhe, pra rreth 45% të vlerës së projektit dedikuar shteteve të regjionit, pra, Kosova është përfituesja më e madhe në këtë projekt.

Në këtë ngjarje ishin të pranishëm përfaqësues të lartë të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Përfaqësues të lartë nga KfW -Banka Zhvillimore dhe Bashkimi Evropian në Kosovë; Donatorë të FK GK-së, Bankat partnere dhe bashkëpunëtorë të shumtë.

Tetor 2024 – Edhe katër anëtarë të tjerë personelit të FK GK-së certifikohen me titullin- Ekspert i certifikuar për Menaxhim të Riskut në shkollën e Frankfurtit për Financa dhe Menaxhim, në trajnimin CERM.

Tetor 2024 – Stafi menaxhues së bashku me anëtarët e bordit menaxhues të FK GK-së ishin pjesë e punëtorisë qëe fasilitoi z. Ole Keding nga Gjermania, e që temat kryesore të punëtorisë ishin: komunikimi, bashkëpunimi, puna ekipore; strategjia dhe performanca.



SCAMPA

NGA STARTUP – NË BINZES GLOBAL RRUGËTIMI I KOMPANISË TË PRODHIMEVE TË PLASTIKËS

Në zemër të Parkut Industrial në Drenas, një biznes tanimë i konsoliduar ishte shfaqur në vitin 2006 si biznes fillestar me ëndrra të mëdha. Nga një ndërmarrje modeste, shumë shpejt dhe bindshëm u shndërrua në kompani të arrirë, falë vizionit dhe energjisë së themeluesit të saj, Kujtim Gjevori. Si çdo biznes, në fillimet e veta "Scampa" u përball me sfida të shumta tipike për startup-et – burime të kufizuara, konkurrencë, si dhe me dinamikat e ndryshueshme të tregut. Megjithatë, i nxitur nga dëshira, ambicia dhe përkushtimi ndaj cilësisë, Kujtimi ishte këmbëngulës në vizionin e tij. Me një ekip të përkushtuar, i cili sot përbëhet nga 50 punonjës, u fokusua në rafinimin e proceseve të prodhimit dhe zgjerimin e gamës së produkteve.

Një nga pikat kryesore të kthesës erdhi kur kompania përqafoi inovacionin dhe investoi në teknologjinë më të fundit të përpunimit të plastikës për prodhim të qeseve me dizajne të personalizuar dhe printim me cilësi të lartë, duke u dalluar nga konkurrentët dhe duke filluar të eksportonin edhe jashtë vendit, në SHBA dhe Evropë. Duke njohur potencialin e tregjeve jashtë shtetit, synimet e këtij biznesi për zgjerim targetuan në mënyrë strategjike sidomos vendet evropiane si Holanda dhe Belgjika, të njohura për standardet e tyre të rrepta të cilësisë dhe bazën e konsumatorëve të ndërgjegjshëm për mjedisin. Këtë a arritën duke lidhur partneritet bashkë-investimi me kompani Belge dhe nëpërmjet planifikimit të përpiktë dhe cilësisë, arritën të depërtojnë me sukses në këto tregje, duke fituar besimin e klientëve.

Qasja dhe kultura e punës që praktikohet në "Scampa" ka nxitur inovacion dhe përmirësim të vazhdueshëm, si në cilësi ashtu edhe kushteve të punës, duke siguruar që kjo kompani të jetë e dalluar në këtë industri. Me investimet në makineri të reja me kapacitete më të mëdha përmes financimit nga bankat, si dhe me garantimin e një pjese të financimit nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore përmes dritares së eksportit që përkrah bizneset eksportuese, rrugëtimi i synuar i këtij biznesi u bë realitet.



Produktet e prodhuara nga Scampa përbëhen nga materialet e ripërdorshme duke filluar prej 80% mbetje PCR (Post Consumer Recycled ose materiali i ricikluar pas konsumit). Pra, i gjithë materiali, në vend që të dërgohet në deponi, ripërdoret dhe i jepet një formë dhe jetë e re.

Pronari i kompanisë na tha se: "Duke përdorur mbetjet PCR në produktet tona, e kemi reduktuar gjurmën e karbonit në mjedis dhe promovojmë qëndrueshmëri. Duke zbatuar qarkun e mbyllur, që nënkupton të gjitha mbetjet e prodhuara në fabrikën tonë gjatë prodhimit riciklohen dhe kthehen në produkt final, riciklimi si dhe projekt i ri në vazhdim e sipër është edhe përdorimi i materialeve të biodegradueshme janë praktika miqësore ndaj mjedisit". Sot, ky prodhues dikur i vogël i qeseve të plastikës, qëndron si shembull i ndritshëm i suksesit ndërmarrës. Me themele të forta, ekip të talentuar dhe një udhëheqës vizionar në krye, ata vazhdojnë të depërtojnë jashtë kufijve të Kosovës dhe të eksplorojnë vazhdimisht mundësi të reja për rritje. Teksa punojnë drejt së ardhmes, një gjë është e sigurt – rrugëtimi i këtij biznesi vendas i ka dyert e hapura drejt më shumë kapitujve të tjerë të sukseseve që ende nuk janë shkruar, por që do të shkruhen në të ardhmen.

LET CENTER NJË SIMFONI E TË MËSUARIT BRENDA BOTËS MAGJEPSËSE TË QENDRËS LET NË PRISHTINË

Në zemër të Prishtinës, në një lagje të re, arrita në Qendrën LET, ku u mirëprita nga fëmijët e buzëqeshur, stafi miqësor, në shoqërimin e Lidës, udhëheqëses energjike që të mbush pozitivitet. Përkushtimi i saj vërehej që në hyrje të Qendrës LET. Së bashku me ekipin e saj, ajo e ka shndërruar këtë qendër në një vend të shenjtë gëzimi dhe mësimi. Gjatë vizitës në Qendër i shihja në fëmijët të cilët, me plot buzëqeshje, që në fillim të ditës angazhoheshin në një sërë aktivitete të krijuara me kujdes për të ndezur kureshtjen dhe zhvilluar imagjinatën. Klasa e sportit të shahut, klasa e artit, klasa e muzikës, klasat e aktiviteteve të llojllojshme, të dizajnuara me aq kujdes për të krijuar ambient miqësor për fëmijët e moshës 0-6 vjeçe.

Të gjitha këndet e Qendrës LET ishin shndërruar në vende për mësim, lojë e aktivitete, ashtu që të shtohet ndjenja e gëzimit dhe kreativitetit. Duke aplikuar lojëra ndërvepruese dhe mësimet përmes lojërave të shumta, edukatorët përfshiheshin me zemër në formësimin e mendjeve të fëmijëve, duke mbjellë dashuri të veçantë për të nxënëit dhe të mësuarit që nuk njih kufij.

“Këtu ku jemi sot kemi arritur me shumë punë dhe përkushtim, së bashku me të gjithë punonjësit e Qendrës LET” – na tha Lida, pronarja/udhëheqësja e kësaj qendre edukimi.

Fillimet e secilit biznes janë të vështira, por, me vendosmëri, ide origjinale dhe përkushtim maksimal, kemi arritur ta hapim këtë qendër, e cila sot ka kapacitet për të pranuar deri në 120 fëmijë. Qasja në financim nuk është fare e lehtë për gratë. Shpeshherë, jemi kategori e shërbyer më pak për sa i përket financimit, meqë nuk kemi prona në emrin tonë. Por, falë bashkëpunimit afatgjatë që kemi krijuar me bankën dhe falë garantimit të kredisë



nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore, kemi arritur ta zgjerojmë biznesin dhe tani, bashkë me Fitoren, motrën time, i kemi dy qendra edukimi për fëmijë, vazhdoi Lida.

Sikurse çdo biznes tjetër, edhe ky lloj biznesi i ka veçoritë dhe sfidat e veta. Në të gjithë jemi të ndjeshëm kur bëhet fjalë për fëmijët dhe edukimin e tyre. Si qendër edukimi, duhet të përçojmë mirëbesim te prindërit, t'i plotësojnë pritjet e tyre, si për nga aspekti përmbajtësor ashtu edhe në ofrimin e kushteve dhe mjedisit cilësor e miqësor për fëmijët.

“Në këtë mënyrë, prindërit na besojnë dhe ndjehen rahat gjatë kohës sa fëmijët janë në qendrën tonë”, tha Lida.

Sot në qendrën tonë i kemi 15 edukatorë dhe 65 fëmijë që vijnë në mësim, të moshës nga 0 deri 6 vjeç. Do të vazhdojmë të jemi qendër arsimit për fëmijët, ku të gjithë do ta ndjejnë sigurinë, mirëqenien dhe profesionalizmin tonë. Do të zgjerohemi edhe më tutje, ashtu që fëmijëve t’ju mbjellim dashurinë për artin, muzikën, edukatën fizike, diturinë e kreativitetin, që të mbjellim farën e mendimit kritik në mënyrë që gjeneratat e reja të kenë prosperitet.

PEZULL NJË BIZNES ORIGINAL

GJENEZA E BIZNESIT "PEZULL"

Medina, Nertila dhe Hira, tri vajza të reja nga qyteti i bukur i Prizreni u bënë bashkë rreth idesë së krijimi të një biznesi inovativ, për të sjellë produkte të inspiruara nga idea e transparencës dhe iluzionit.

Gjatë viteve të studimit, si adhuruese të modës dhe kreacioneve origjinale, vendosën që ta themelojnë një biznes të ri, pikërisht në vitin 2021, themelueset e këtij brendi përkujdesen që dizajnimi, qepja dhe marketingu të bëhen nga duart dhe idetë e këtyre tri themelueseve. "Pezull" emëruan biznesin e ri dhe filluan me kreacione origjinale duke depërtuar tanimë edhe në tregje ndërkombëtare.

KUALITETI DHE RISITË NË BOTËN E MODËS!

Një nga karakteristikat e këtij biznesi inovativ është që kreacionet e tyre janë nga materiale të riciklueshme. Trendet, idetë dhe dizajnet e veçanta bënë që për kohë të shkurtër të arrijnë rezultate dhe të bëhen tregim sukcesi dhe inspirim për vajzat tjera që e duan modën dhe ndërmarrësinë.

Produktet e tyre si: çanta, fustane, këmisha, komplete, bluza e funde me kolorite dhe modele të nduarduarshme, të qepura me shumë finesë, janë krijuar nga materiale transparente, të riciklueshme dhe kjo i bën këto kreacione të jenë shumë të kërkuara nga klient të ndryshëm.

VIZIONI PËR TË ARDHMEN

Themelueset e biznesit "Pezull" vazhdojnë të shtyejnë kufijtë e një mode të qëndrueshme. Vizioni i tyre është që ta zgjerojnë prodhimin e produkteve në

një gamë edhe më të pasur me modele e kreacione, duke i finalizuar me shumë përkushtim e dashuri.

Produktet nga "Pezull" do të vazhdojnë të jenë të punuara me materiale të riciklueshme, jo vetëm për të sjell origjinalitet por të njejtën kohë duke kontribuar edhe në ruajtjen e ambientit.





FONDI KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE
KOSOVSKI FOND ZA KREDITNO JEMSTVO
KOSOVO CREDIT GUARANTEE FUND

Buletin i FKGK-së

EDICIONI I TETË | Nëntor 2024

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore

Adresa:
Njazi Alishani Nr. 5,
10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 (0) 38 225 600
info@fondikgk.org

www.fondikgk.org